

VENDIM
Nr.448, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.455, DATË 18.7.2007 “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor”, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.455, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave, miratuar për vitin 2009.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT PYJOR

Nr.	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	18 000
2.	II	18 300
3.	III	18 600
4.	IV	18 900
5.	V	19 200
6.	VI	19 500
7.	VII	20 500
8.	VIII	21 500
9.	IX	22 000
10.	X	23 000
11.	XI	24 000
12.	XII	24 500
13.	XIII	25 000
14.	XIV	26 000
15.	XV	28 000
16.	XVI	29 000
17.	XVII	30 500
18.	XVIII	31 500
19.	XIX	32 000

20.	XX	33 000
21.	XXI	35 000
22.	XXII	36 000
	XXIII	38 000